

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **624-25-2877-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Sherbimet e pastrimit të objekteve të mbrendshme dhe të jashtme DDD të objekteve shkollore - Qerdheve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	D D D SH.P.K.
NUI	811319955
Adresa	rr. Ahmet Krasniqi, obj.Vicianum K-3, ARBERI
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	048166909
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Shaip Berisha
Adresa elektronike	nshp.ddd@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	11.07.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sherbimet e pastrimit të objekteve të mbrendshme dhe të jashtme DDD te objekteve shkollore - Qerdheve

B05 Njoftim per Kontrat 10.04.2025 09:42

Template per Dosja e Tenderit - Shqip - Korigjim 1.doc26.05.2025 16:14

Pershkrimi i qmimeve - korigjim.xlsx26.05.2025 16:16

14-B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues.pdf27.06.2025 15:57

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

14-Procesverbali i Hapjes se ofertav -DDD.PDF09.06.2025 14:11

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesë për rishqyrtim - Kërkesë për Ri-shqyrtim30.06.2025 23:05

Vendim Refuzim Sherbimet e DDD GOE DDD SHPK DOCTOR

SHPK.pdf04.07.2025 11:36

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit,

dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne, si GOE , në përputhje me Nenin 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, paraqesim ANKESE ndaj vendimit të AK KK Suhareka për eliminimin tonë nga procedura e lartpërmendur, për arsyet e mëposhtme:

Në Pretendimin 1 në kërkesën Nr. 5 në DT – Epidemiolog, Ekolog ose Biolog

Në vendimin e AK thuhet se:

“Operatori Ekonomik ka ofruar dëshmi vetëm për një Epidemiolog dhe nuk ka sjellë Ekologun ose Biologun.”

Ky interpretim është i gabuar, pasi që në DT kërkohet qartë:

“Një Epidemiolog, Ekolog ose Biolog me përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit.”

Interpretimi Gramatikor i "ose"

Kur fraza "Një Epidemiolog, Ekolog ose Biolog" shfaqet në një dokument zyrtar, interpretimi gramatikor i "ose" është i qartë:

Zgjedhje e Veçuar: Lidhëza "ose" tregon se nga grupi i profesionistëve të listuar (epidemolog, ekolog, biolog), është e mjaftueshme prania ose kontributi i njërit prej tyre. Nuk kërkohet që të jenë të pranishëm të tre. Kjo është thelbi i funksionit të "ose" – ajo ofron një alternativë, jo një bashkëpërmbushje.

Ne oferten tone ne kemi dorëzuar:

- Diplomën e Epidemiologut, dëshminë për përvojën e punës mbi 5 vite pas diplomimit, CV të nënshkruar, Kontratë/parakontratë specifike për projektin.

Nga kjo ne si GOE i përmbushim plotësisht kriteret minimale sipas terminologjisë OSE, pa asnjë devijim nga DT. Çdo interpretim ndryshe i tejkalon kufijtë e tekstit të qartë dhe shkelë rendë barazinë e konkurrencës.

Poashtu në vendimin e AK në Pretendimin 1 është një kontraktidë citojmë: GOE në fjalë

ka sjellur vetëm Epidemiologun dhe nuk ka sjellur Ekologon apo Biologun (Biologu është sjellur në përmbushje të kërkesës nr. 7, pra si menaxher i Kontratës dhe jo staf profesional siç kërkohet në kërkesën nr.5), OE ka ofruar dëshminë: Diplomën e noterizuar, CV-në e nënshkruar dhe kontratën e punës e nënshkruar.

Në kontratën ne mes te ekspertit dhe DDD SHPK ceket saktësisht në nenin 3, Angazhim për punë të DDD-së ne pozitën Menaxher i projektit- Biolog. Bazuar ne kete pershkrim “Biologu” në këtë rast është edhe menaxher i ketij projekti si dhe njeherit bazuar në edukimin e tij profesional, përvojen e punës (me shumë se sa është kërkuar në DT) është staf profesional dhe ate i mbikualifikuar bazuar në kerkesat ne DT.

Në Pretendimin 2. Kërkesa Nr. 7 e DT – Menaxheri i Kontratës (Biologu)

Sipas vendimit, është theksuar që:

“Kontrata e Biologut nuk mbulon periudhën 36 muajsh dhe kufizohet në 120 ditë pune brenda vitit.”

Ne si GOE kemi dorëzuar kontratën, ku:

Në Nenin 3 saktësohet periudha e angazhimit që mbulon tërësisht afatin 36-mujor të kontratës kornizë.

Në fakt, në kontratën e dorëzuar nga OE DDD SHPK dhe z. Daut Shabani citojmë:

- Neni 3 i kontratës saktëson që angazhimi lidhet drejtpërdrejt me shërbimet për periudhën kohore që do të zgjasë projekti.

- Neni 4 i kontratës: Shihet qartë se punëmarrësi e fillon punën në momentin kur të nënshkruhet kontrata nga OE me AK dhe jo sic ka interpretuar AK.

“Punëmarrësi fillon punën pas nënshkrimit të kontrates me Autoritetin kontraktues. Koha e propozuar është indikative, përderisa fillimi i angazhimit do të varet nga data e fillimit të punëve. Punëdhënësi do të njoftoj punëmarrësin së paku 7 ditë, përpara fillimit të zbatimit për punë.” (të bashkangjitur gjeni kontratën)

- Neni 6 i kontratës konfirmon qartë si në vijim:

“Punëmarrësi në angazhim, për punët dhe detyrat e përcaktuara sipas Nenit 3 të kësaj Kontrate, do të angazhohet pas nënshkrimit të kontratës, deri në përfundim të projektit, gjithsej, maksimumi 120 ditë gjatë një viti kalendarik.”

Ky formulim konfirmon qartë se kontrata hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet valide për të gjithë kohëzgjatjen e projektit , në përputhje të plotë me kontratën publike kornizë.

Pra, pretendimi se kontrata nuk e mbulon periudhën e plotë është i gabuar, sepse:

- Periudha e vlefshmërisë ligjore është e qartë (37 muaj).
- Kontrata nuk përfundon automatikisht pas 120 ditëve, por zbatimi i punës kryhet sezonalisht brenda vitit, në përputhje me Ligjin e Punës (Neni 10 pika 6) dhe FTD.

Kufizimi me 120 ditë pune brenda vitit është i parashikuar në Ligjin e Punës (Neni 10, pika 6), i cili lejon kontrata për detyra specifike me këtë kufizim të saktë.

Shërbimet DDD kryhen me urdhra blerjeje, sipas FTD-së pika 5.4, gjë që e bën plotësisht të natyrshme menaxhimin e orëve të punës me fleksibilitet sezonal.

Për më tepër, në vendim theksohet se Operatori nuk ka paraqitur Biologun, por njëkohësisht analizohet kontrata e Biologut. Kjo tregon kontradiktë: nuk mund të mungojë diçka që njëkohësisht gjykohet për vlefshmëri.

Në përputhje me nenin 10, dhe nenin 11 paragrafi 1, të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe Punëmarrësi, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin këtë:

KONTRATË PUNËS ME ANGAZHIM

Neni 1

“DDD” SH.P.K., me NUI: 811319955, adresa: rr. Ahmet Krasniqi, Obj. VICIANUM K-3, lokali 10, Prishtinë, të cilin e përfaqëson: z. **Shaip Berisha** (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë të punës për angazhim në punë sezonale me: **Daut Shabani me nr. personal: 1012860303** ne pozitën: **Menaxher i projektit**.

Neni 2

Punëdhënësi i ofron, ndërsa punëmarrësi pranon të lidhë kontratë të punës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindënjëzetë (120) ditë pune brenda një (1) viti.

Neni 3

Angazhim për punë të DDD-së ne pozitën Menaxher i projektit- **Biolog** (me kohë të caktuar), të cilat duhet t'i kryejë punëmarrësi për punëdhënësin, konsistojnë në:

Sherbimet e pastrimit te objekteve te mbrendshme dhe te jashtme DDD te objekteve shkollore - Qerdheve, me nr. të prokurimit: 624-25-2877-2-1-1 për vitet 2025, 2026 dhe 2027 (37 muaj).

Neni 4

Punëmarrësi fillon punën pas nenshkrimit të kontratës me Autoritetin kontraktues. Koha e propozuar është indikative, përderisa fillimi i angazhimit do të varet nga data e fillimit të punëve. Punëdhënësi do të njoftoj punëmarrësin së paku 7 ditë, përpara fillimit të zbatimit për punë.

Neni 5

Nëse punëmarrësi nuk e fillon punën ditën e caktuar, sipas marrëveshjes në këtë Kontratë, pa e paralajmëruar punëdhënësin për arsyet e mos fillimit të punës, do të konsiderohet se me vullnetin e vet, e ka shkëputur këtë kontratë në mënyrë të njëanshme.

Neni 6

Punëmarrësi në angazhim, për punët dhe detyrat e përcaktuara sipas nenit 3 të kësaj Kontrate, do të angazhohet pas nenshkrimit të kontratës, deri në përfundim të projektit, gjithsej, maksimumi 120 ditë/gjatë një viti kalendarik. Punëmarrësi pas përfundimit të kësaj kontrate, nuk gëzon të drejta, të cilat burojnë nga kjo kontratë, në kohën që, sikur e njëjta që është valide.

kontratë për bashkëpunim me ekspertin për siguri dhe shëndet në punë, e cila nuk është në harmoni me kërkesën e Autoriteti Kontraktues pasi që e njëjta nuk ka të dhëna si: Kohëzgjatja e kontratës (validiteti), numri personal i ekspertit, ditëlindja, vendbanimi, shuma e pagës etj, si dhe autoritetit kontraktues i referohet si Investitor.

Po ashtu AK nuk e ka specifikuar në dosjen e tenderit se në kontratë duhet të ceket nr. personal, ditëlindja, vendbanimi, shuma e pages, etj.

Ne si GOE kemi ofruar Kontratë bashkëpunimi në mes të ekspertit Muhamet Hamiti dhe DDD SHPK, ku specifikohet qartazi Emri i Projektit, Nr. i prokurimit dhe data e kesaj kontrate.

Pretendimi i AK që kjo kontratë është për ndonjë investim NUK qëndron pasi që në këtë kontratë tek përshkrimi Investitori është drejtuar për AK, pra KK Suharekë gjë që realisht është investitor në këtë projekt / aktivitet të prokurimit publik.

Po ashtu në këtë kontratë është e cekur se për detaje të këtij bashkëpunimi për këtë projekt në mes të ekspertit Muhamet Hamitit dhe DDD SHPK është një parakontratë e cila i precizon të gjitha detajet si ato që AK i ka përshkruar në pretendimin nr. 3, por prapë se prapë AK nuk e ka parë të arsyeshme të thirret në Nenin 59 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të kërkojë sqarim me shkrim, për të verifikuar të dhënat, përpara se të marrë vendim eliminues. Thirrja në nenin 59 për sqarime nuk përbën ndryshim material, por një konfirmim procedural që e lejon ligji dhe njeherit do të bëhet një vlerësim real i të gjitha ofertave dhe nuk do të paraqiste ndonjë dyshim në favorizim.

Investitori:

KOMUNA SUHAREKË

Titulli i kontratës:

Sherbimet e pastrimit të objekteve të mbrendshme dhe të jashtme DDD të objekteve shkollore - Qerdheve

Nr i Prokurimit:

624-25-2877-2-1-1

Data:

05.06.2025

Kontratë bashkëpunimi

Me këtë kontratë:

DDD SH.P.K., Adresa: Rruga Ahmet Krasniqi, Objekti Vicianum, K-3, Prishtinë, me NUI 811319955 të cilën e përfaqëson Shaip Berisha

lidhë kontratë pune me:

Muhamet Hamiti, Pozita: Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë

Obligimet dhe përgjegjësitë:

Unë nënshkruesi, i autorizuar i kompanisë "D D D" SH.P.K., vërtetoj me këtë se do të bashkëpunojë me Muhamet Hamiti, Pozita: Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë gjatë kryerjes së punëve në projektin e lartë përmendur.

Unë Muhamet Hamiti, vërtetoj me këtë se do të bashkëpunojë me kompaninë "D D D" SH.P.K., për projektin e lartë përmendur prej nënshkrimit të kontratës e deri me përfundimin e projektit në fjalë.

Në rast të ndonjë ndryshimi eventual gjatë implementimit të projektit të kësaj Marrëveshje ne do ta informojmë menjëherë me shkrim investitorin.

Detalet e bashkëpunimit në mes kompanisë "D D D" SH.P.K., dhe Muhamet Hamiti, janë të definuar në mënyrë më të qartë me anë të parakontratës interne mes tyre.



Muhamet Hamiti

Mungesa e përputhshmërisë së lejes së importit me kërkesat e AK ne DT per preparatet biocide

Grupi i Operatorëve Ekonomik që janë shpallur fitues kanë paraqitur në lejen e importit me numër 25/526-38/-DDMU të datës 10.02.2025 lëshuar për OE Samire Osmani B.I. për import të produkteve biocide, ku kjo Leje e importit nuk i plotëson kërkesat e DT të kërkuara në Specifikimet Teknike të Detyrueshme ANEKSI 1.

Kërkesa në Aneksin 1:

“- Preparatet repelente kunder insekteve në formë të granulave që nuk janë të rrezikshme për njerëzit dhe ambientet duhet të jenë me materie aktive natyrale, materie acitve si: Citronela, Alium, Aativum me sasi 100gr/m2 - ekuivalente si dhe duhet te kete lejen per perdorim nga Ministrija e Ambientit dhe Planifikimit Hapsnior

-Preparatet në formë të granulave për largimin e zvarranikëve (gjarpërinjëve)”

Bazuar në kërkesat e Aneksit 1. ne DT, GOE i shpallur fitues ne lejet zyrtare te importit siq jane:

Leja e importit me numër 25/526-38/-DDMU të dates 10.02.2025 e lëshuar për SAMIRE OSMANI B.I. dhe

Leja e importit me numër 24/2652-233/-DDMU të dates 08.05.2024 e lëshuar për MBUROYA SHPK (E SKADUAR-duke ju referuar dokumenit zyrtar ku shkruan se leja e importit për produkte biocide lëshohet për periudhen një vjecare) që kanë dorëzuar Grupi i Operatorëve Ekonomik: Eko Lan Group SHPK dhe Mburoya SHPK , rezulton se produktet biocide si: Citronella, Allium sativum dhe Cyming Ultra te cilat jane te kerkuara ne Aneksin 1, nuk janë në lejet e importit respektive dhe nuk ka preparate ekuivalente per keto produkte në lejet e cekura.

Në lejen e importit 25/526-38/-DDMU të dates 10.02.2025 e lëshuar për SAMIRE OSMANI B.I. figurojnë vetëm këto produkte:

VENDIM

Aprovohet kërkesa e kompanisë “ Saimire Osmani B.I. “- Leshan -Suharekë për Leje Imj të produkteve biocide. Lista e produkteve biocide që do të importohen:

Substanca aktive	Produkti	Sasia / forma	Nr. i notifikimit	Lloji produktit biocid (PT)
Deltamethrin	Aqua K-Othrine	500 copa	3684/526/25/KOS	Insekticid
Alphacypermethrin	Zinon EW	400 copa	3685/526/25/KOS	Insekticid
Cyfluthrin	Solfac 050 EW	100 copa	3686/526/25/KOS	Insekticid
Enzyl-C12-16 alkyl dimethyl, chlorides	Dimersept 10	10000 copa	3687/526/25/KOS	Dezifektant
Difenacoum	Titan Wax Block	500 kg	3688/526/25/KOS	Rodenticid

Produktet biocide nga tabela e më sipërme duhet të menaxhohen sipas kushteve të parapara në Listat përkatëse Teknike të Sigurisë për Kimikate (Safety Data Sheet). Kompania në fjalë është e obliguar të bëjë transportimin e produkteve biocide duke iu përmbajtur kushteve të ADR.

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 383 38 517 638; +383 38 517 558

Pra GOE nuk kanë ofruar ndonjë preparat tjetër i cili është ekuivalent dhe njeherit i është lejuar importi, bazuar në kërkesat e AK në DT. Për sqarim me detaj në lejet e importit të GOE të shpallur fitues nga AK nuk ka asnjë preparat i cili i përmbush kriteret bazike apo ekuivalente. (Ju lutem referojuni lejeve të importit të dorzuara nga ana e GOE të shpallur fitues nga AK).

Pra GOE-së i mungojnë preparatet repelente kundër insekteve në formë të granulave dhe preparateve për largim të zvarranikëve.

Nese beni krahasimin e lejeve me GOE: DDD SHPK & Doctor Exterminator DDD SHPK (te eliminuar) do të shihni dallimin ku në rubrikën repellent egzistojnë produktet biocide të cilat perputhen me kërkesat e DT, Aneksi 1.

GOE: Eko Lan Group SHPK nuk ka ofruar leje të importit për produkte biocide;

OE MBUROYA SHPK ka ofruar leje të importit të SKADUAR.

GOE kanë ofruar leje në emer të SAMIRE OSMANI B.I. i cili biznes në faqen e ARBK-së është si biznes i shuar dhe nuk mund të importoj produkte me këtë leje, Bazuar në Ligjin për sistemin e lejeve dhe licencave 04/L-202 , Neni 22,Neni 23,Neni 24,Neni 25.

AK me këtë rast ka bërë shkelje ligjore duke shpallur GOE fitues edhe pse i njejti GOE nuk i plotëson kërkesat e paraqitura në DT të AK-Komuna Suharekë.

Boric acid	Niban granular bait	500 kg	3272/4667/24/KOS	Insekticid
Permethrin	Master Line-Aqua Kontrol 30-30	1500 lit	3273/4667/24/KOS	Insekticid
Pyrethrins	P.I.	240 kanister	3274/4667/24/KOS	Insekticid
Lambda cyhalothrin	Demand CS	200 lit	3275/4667/24/KOS	Insekticid
Pyriproxyfen	Archer	120 lit	3276/4667/24/KOS	Insekticid
Bacillus thuringiensis israelensis	Aquabac (200 g)	200kg	3277/4667/24/KOS	Larvicid
Bacillus thuringiensis israelensis	Aquabac XT	200 lit	3278/4667/24/KOS	Larvicid
Methoprene	Altoisid XR Briquets-S-	500 kg	3279/4667/24/KOS	Larvicid
Difethialone	Generation Mini Blocks	1000 kg	3280/4667/24/KOS	Rodenticid
Brodifacoum	Ratimor Brodifacoum Wax Blocks	500 kg	3280/4667/24/KOS	Rodenticid
Bromodiolon	Ratimor Wax Blocks	500 kg	3281/4667/24/KOS	Rodenticid
Bromodiolon	Ratimor Fresh Bait	200 kg	3282/4667/24/KOS	Rodenticid
Clove Oil	Snake Out - Snake repellent Granula	500 kg	3283/4667/24/KOS	Repellent
Polybutenes	Transparent 4 the bird Gel-Bird Repellent	339.6 kg	3284/4667/24/KOS	Repellent
Polybutenes	Transparent 4 the bird -Bird Repellent Liquid	757 lit	3285/4667/24/KOS	Repellent
Methyl Anthranilate	Fog Force -Bird Repellent	757 lit	3286/4667/24/KOS	Repellent
Dydecyldimethyl Ammonium Chloride	Actosal Flache AF	200 lit	3287/4667/24/KOS	Dezinfektant

Produktet biocide nga tabela e më sipërme duhet të menaxhohen sipas kushteve të parapara në Listat përkatëse Teknike të Sigurisë për Kimikate (Safety Data Sheet).
 Kompania në fjalë është e obliguar të bëjë transportimin e produkteve biocide duke iu përmbajtur kushteve të ADR.



Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive duke u bazue në nenit 43 të Ligjit Nr. 08/L-065 për Produktet Biocide, si dhe nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate, nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa e kompanisë "DoctorExterminator D.D.D." – Sh.p.k.-Prishtinë për Leje Importi të produkteve biocide. Lista e produkteve biocide që do të importohen:

Substanca aktive	Produkti	Sasiia / forma	Nr. i notifikimit	Lloji i produktt biocid (PT)
Citronellal	Granuli alla citronella	700 kg	3943/2275/25/KOS	Repelent

Produktet biocide nga tabela e më sipërme duhet të menaxhohen sipas kushteve të parapara në Listat përkatëse Teknike të Sigurisë për Kimikate (Safety Data Sheet).

Kompania në fjalë është e obliguar të bëjë transportimin e produkteve biocide duke iu përmbytur kushteve të ADR.

Kompania në fjalë, është e obliguar ta njoftoj MMPHI me shkrim, pas çdo realizimi të importit produkteve biocide në sasinë e lejuar për të cilën lëshohet Leja.

Leja për Import për produkte biocide lëshohet për periudhën 1 (një) vjeçare

A r s y e t i m

Shkelje në barazinë në garë

Ne, si GOE kemi ofruar preparate që janë të harmoni me kërkesat e DT dhe bashkangjitur me leje të vlefshme importi, duke garantuar gjurmueshmëri, përputhshmëri ligjore dhe siguri për ekzekutimin korrekt të kontratës.

AK me të shpallur fituese ofertë e GOE të papërgjegjshme dhe me qmim më të lartë është në kundërshtim me kërkesat bazë të cilat vet AK i ka kerkua ku dhe me kete raste sipas mendimit tone kane bere shkelje flagrante të dispozitave ligjore të LPP.

Me kete rast ne si GOE jemi te diskriminuar si ne aspektin profesional po ashtu dhe ate ekonomik pasi qe eshte bere nje e padrejtë bazike ligjore.

Në bazë të të gjitha argumenteve të paraqitura, ju kërkojmë:

Vendim:

Anulimin të vendimit për dhënie të kontratës,

Rivlerësimin e ofertave,

Dhënien e kontratës ofertës tonë si oferta më të lirë të përgjegjshme.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Bllokim i kapaciteteve teknike dhe njerëzore për një periudhë të gjatë.

Kosto të humbura për shkak të kufizimit të konkurrencës.

Dëmtim i reputacionit si kompani konkurruese në tregun publik.

Humbje e fitimit të parashikuar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.